



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/791

Datë: 8 / 12 / 2014

Në mbështetje të nenit 149; 150; 151 dhe 152 të statutit të Universitetit të Prishtinës, Senati i UP-së në mbledhjen e datës 25.11.2014 mori:


VENDIM

mbi kushtet e regjistrimit te vitit shkollor dhe limitet e SEMS-it

1. Studentët e vitit të parë të studimeve themelore bachelor dhe të studimeve master, vitin e dytë e regjistrojnë me jo më shumë se një provim të mbetur. Pastaj vitin pasardhës e regjistrojnë me vitin paraardhës të përfunduar dhe jo më shumë se dy provime të mbetura nga viti paraprak.
2. Viti nuk mund të përsëritet më shumë se njëherë. Përfundimisht viti mund të përsëritet edhe herën e dytë me kërkesë të arsyetuar dhe me miratimin e dekanit të njësisë akademike, por jo më shumë se një herë gjatë studimeve. Për këtë duhet të njoftohet me shkrim prorektori për mësimdhënie dhe çështjeve për studentë.
3. Studimet nuk mund të zgjasin më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes së paraparë me programin përkatës. Përfundimisht studimet mund të vazhdohen vetëm edhe për një vit shkollor me kërkesë të arsyetuar dhe me miratimin e dekanit të njësisë akademike. Për këtë duhet të njoftohet me shkrim prorektori mësimdhënie dhe çështjeve për studentë.
4. Studenti që humbë vitin në programin që përfundon së ekzistuari, studimet mund t'i vazhdoj vetëm me një program ekzistues tjetër. Provimet që i përshkruhen si ndryshim gjatë ndërrimit të programit i regjistrohen dhe nuk i llogariten për kusht të regjistrimit në atë vit.
5. Viti shkollor regjistrohet më së voni deri më 30 shtator. Me arsyetim të veçantë, dekani i njësisë mund të lejoj regjistrimin pas këtij afati por për këtë duhet të njoftoi me shkrim prorektorin për mësimdhënie dhe çështjeve për studentë.
6. Ky vendim do të zbatohet për të gjithë studentët e nivelit të studimeve bachelor dhe master të cilët regjistrohen për herë të parë në Universitetin e Prishtinës nga viti akademik 2014/15.

Vendimi t'i dorëzohet:

1. Menaxhmentit të UP-së,
2. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së
3. Dekanëve të njësive akademike te UP-së,
4. Sekretarëve të njësive akademike
5. Zyrtarit Ligjor të UP-së
6. Arkivit të UP-së.



Prof. dr. Ramadan Zejnullahu

Rektor i UP-së